



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr.02, datë 25.04.2023

PËR
MIRATIMIN E RISHIKIMIT TË PLANIT TË PËRGJITHSHËM VENDOR BASHKIA
HIMARË, TË MIRATUAR ME VENDIMIN NR.2, DATË 16.10.2017 TË KËSHILLIT
KOMBËTAR TË TERRITORIT, I NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 7, 20, 25 dhe 26 të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar, të neneve 11 dhe 12 të Vendimit Nr. 686, datë 22.11.2017 të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit”, të ndryshuar, të Vendimit Nr. 519, datë 20.09.2017 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, i ndryshuar, të Vendimit Nr.2, datë 16.10.2017 të KKT-së “Për miratimin e Planit të Përgjithshëm Vendor, Bashkia Himarë”, i ndryshuar, me propozim të Kryetarit të Bashkisë Himarë, si dhe referuar Vendimit të Këshillit të Bashkisë Nr.23 datë 11.04.2023, Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:

1. Në Planin e Përgjithshëm Vendor Bashkia Himarë, të miratuar me Vendimin Nr.2, datë 16.10.2017, të Këshillit Kombëtar të Territorit, të bëhen ndryshime në:

- *Tabelat e tregueseve të zhvillimit të njësive strukturore*

sipas Dokumentit të Rishikimit të Planit të Përgjithshëm Vendor Bashkia Himarë, bashkëlidhur këtij Vendimi.

2. Ngarkohen Bashkia Himarë dhe Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit për botimin e Vendimit dhe dokumentit shoqërues të tij, në Regjistrin Kombëtar të Planifikimit të Territorit, si dhe për përditësimin e informacionit GIS dhe platformës e-Harta, sipas ndryshimeve të miratuara.
3. Ngarkohen Bashkia Himarë, Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit, si dhe autoritetet përgjegjëse për planifikimin dhe zhvillimin e territorit për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.



MINISTËR I LINJËS

MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË

BELINDA BALLUKI



ANËTAR / SEKRETAR I KKT

DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

LEDIA TOTA

